

Rrjeti për Ruajtjen e Cetaceve dhe Breshkave Detare në Adriatik

Projekti NETCET financohet nga Programi IPA Adriatik CBC dhe përfshihet në Prioritetin 2 "Burimet Natyrore dhe Kulturore dhe Parandalimi i Rreziqeve".

Qëllimi kryesor i këtij programi bashkëpunimi ndërkuftar është forcimi i kapaciteteve për një zhvillim të qëndrueshëm të rajonit të Adriatikut, nëpërmjet një strategjie të përbashkët aktivitetesh midis vendeve partnere të këtij rajoni.

Faqja ëeb e projektit: www.adriaticpacbc.org

SUMMARY

Të njihemi me cetacetë dhe breshkat detare që jetojnë në Detin Adriatik

Hapat e parë të NETCET për ngritjen e një Rrjeti Shkencor...

Si mund ta ndihmojmë një breshkë deti të plagosur, ose të dalë në breg?

Workshopi Riccione, Shkurt 2013

Workshopi Losinj, Mars 2013

Kurset e trajnimit veterinar të NETCET

1. Të njihemi me cetacetë dhe breshkat detare që jetojnë në Detin Adriatik

Breshkat e detit



Mund të ndodhë që kur noton apo navigon në ujrat e Adriatikut, të shohësh diçka që ecën shpejt, për disa minuta, nën sipërfaqen e ujit. Është

silueta e errët e një breshke deti. Të mësuara me këtë det, breshkat janë vizitore të vetmuara, por disa herë në vit mund të jenë edhe të shumta. Në shumicën e rasteve, të gjitha breshkat e detit të para në detin tonë i përkasin të njëjtit lloj, breshkës së zakonshme të detit, e njohur me emrin shkencor *Caretta caretta*. Në Mesdhe mund të shihen edhe dy lloje të tjera breshkash detare, breshka e gjelbër *Chelonia mydas*, e cila është e rrallë, si dhe breshka

gjigande kurrizlëkurore dhe shumë e vecantë, *Dermochelys coriacea*. Dy llojet e fundit zakonisht nuk janë të pranishme në Adriatik, megjithatë ka raste kur ato vërehen sidomos në Adriatikon jugor.

Breshka e zakonshme *Caretta caretta* është më e vogla e breshkave të detit në Mesdhe, duke arritur në 110 cm gjatësi të karapaksit dhe peshë deri në 180 kilogram. Karapaksi, me ngjyrë kafe në të murrme, në individët e rinj ka dhëmbëzim dorsal, ndërsa plastroni është i verdhë. Koka,

e mbuluar me luspa, është e gjerë dhe e fortë dhe kjo është arsyeja pse ky lloj në anglisht quhet breshka kokëtrashë (loggerhead). Në individët e rritur meshkuj bishti është dukshëm më i gjatë se tek femrat.

Kjo breshkë është gjetur në ujërat e klimës mesatare në të gjithë botën. Në Mesdhe, vendet e folezimit janë gjetur kryesisht në zonën lindore dhe përfshijnë Greqinë, Turqinë, Cipron, Libinë dhe më pak

Sirinë, Izraelin, Tunizinë dhe Egjiptin. Mendohet se folezimi i saj, ndonëse në sasi të vogël, ndodh përgjatë gjithë bregdetit mesdhetar të Afrikës së Veriut. Ky lloj breshke detare është i vetmi që folezion në brigjet italiane: në jug, dhe në Ishujt Pelagie.

Caretta caretta ushqehet me peshq, sidomos me lloje peshqish që jetojnë në livadhet e Posidonias. Megjithatë, në ujra të cekët ajo ushqehet edhe me krustace

(gaforre), karkalecë dhe molusqe që jetojnë në fund të detit. Kjo breshkë është një lloj oportunist, që ushqehet me çdo gjë që mund të gjejë.

Në periudhën e riprodhimit kjo breshkë lëshon nga 40 deri në 190 vezë. Periudha e lëshimit të vezëve në Mesdhe shtrihet nga fundi i pranverës deri nga fillimi i vjeshtës. Lëshimi i vezëve nuk ndodh çdo vit dhe intervali midis cikleve paraqet mjaft variacione

Cetacete

Tetë lloje cetaceshë janë konsideruar si rregullisht të pranishme në Mesdhe. Gjithashtu, ka disa lloje të tjera që shihen në mënyrë rastësore.

Deti Adriatik megjithatë, për shkak të karakteristikave të tij kimike dhe fizike, ka vetëm një lloj të stabilizuar: delfinin hundëshishe *Tursiops truncatus*.

Mund të ndodh të shihen në mënyrë sporadike edhe lloje të tjera si: balena me pendë (*Balaenoptera physalus*), kashaloti (*Physeter macrocephalus*), delfini i zakonshëm (*Delphinus delphis*), delfini i Risos (*Grampus griseus*) Risso's dolphin, si dhe delfini me vija (*Stenella coerulealba*), por duke u kufizuar vetëm në pjesën jugore të Adriatikut, në jug të kepit të Garganos.



Delfini hundëshishe është një odontoce që preferon përgjithësisht habitatet bregdetarë dhe mund të gjendet në pothuajse të gjitha detet e globit. Ai është gjithashtu delfini më i zakonshëm në delfinariumet dhe akuariumet nëpër botë. Mendohet se ky është gjitari detar i vetëm me prani të rregullt në pjesën qendrore dhe veriore të Adriatikut. Ky lloj paraqet një ndryshueshmëri të madhe gjeografike dhe popullatat e ndryshme kanë karakteristika morfologjike dhe ekologjike me shumë variacione. Në përgjithësi, ka një formë bregdetare dhe një oqeanike. Në Mesdhe gjatësia mesatare është rreth 2,5 - 3,5 m, me një peshë prej 270 - 350 kg. Lëkura ka hije gri, shpesh me zona të bardha. Barku është i bardhë.

Pjekuria seksuale tek femrat ndodh rreth moshës 5 - 13 vjeç, ndërsa për meshkujt mes 9 dhe 14 vjet. Sezoni i shumimit shkon nga janari deri në fund të marsit dhe ngjizja zgjat rreth 12 muaj. Në kohën e lindjes së tyre, madhësia e individëve të Mesdheut është vlerësuar rreth 1.1 m.

Femra lind një foshnje të vetme gjatë një shtatëzanie (përveç rasteve shumë të rralla të të lindurve binjakë), me një mesatare prej 8 të lindurish në një periudhë 30 vjecare të jetës. Zakonisht, periudha mes dy lindjeve shkon rreth 3 vjet.

Dieta e delfinit hundëshishe duket të jetë shumë e larmishme, duke qenë një lloj oportunist dhe duke u ushqyer me atë çfarë mjedisi mund të ofrojë në sasi më të madhe. Preja e tij përbëhet nga cefalopodë, peshq të vegjël pelagjikë, gastropodë dhe organizma të tjerë benthikë.

Delfini hundëshishe nuk kapet shpesh në rrjeta apo mjete të tjera peshkimi, por dëmtimi më i madh për këtë lloj vjen nga pakësimi i ushqimit, shkaktuar nga mbipeshkimi dhe ndotja e ujrave detare.

Marco Affronte

2. Hapat e parë të NETCET për ngritjen e një Rrjeti Shkencor dhe Qytetar për mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare.

Rrjeti Shkencor/Teknik

Objektivi kryesor i projektit NETCET është të zhvillojë strategji të përbashkëta për ruajtjen e breshkave të detit dhe cetaceve në Adriatik, nëpërmjet bashkëpunimit rajonal. Një nga qëllimet kryesore është nxitja e bashkëpunimit dhe forcimi i rrjetit midis institucioneve të përfshira në mbrojtjen e breshkave detare dhe cetaceve në të gjithë Adriatikut.

Kështu, një nga aktivitetet e NETCET është "Ngritja e një rrjeti teknik dhe shkencor midis organizatave dhe ekspertëve të Adriatikut, duke forcuar lidhjet me rrjete të ngjashme në Mesdhe". Për të arritur këto qëllime, janë krijuar disa mekanizma (shiko në kutinë blu):



Rrjeti Qytetar për Adriatikut



Brenda projektit NETCET është parashikuar të ngrihet edhe Rrjeti Qytetar për Adriatikut; qëllimi është rritja e ndërgjegjësimit të qyteteve përsa i përket rolit të tyre për mbrojtjen e breshkave detare dhe cetaceve. Qytetet përgjatë Adriatikut, të cilët synojnë të marrin pjesë në këtë Rrjet, duhet të marrin përsipër që të bëjnë të qartë për publikun e gjerë kërcënimet për këto lloje të rrezikuara dhe të përfshihen në punën për reduktimin e rreziqeve direkte për këto kafshë detare (për shembull duke promovuar kufizimin e ndjeshëm të varkave në zonat e rëndësishme për breshkat detare dhe cetacetë).

Për të krijuar një bashkëpunim sa më konkret, anëtarët e Rrjetit Qytetar NETCET, do të ftohen gjithashtu për të nënshkruar një marrëveshje zyrtare dhe së bashku me Konferencën Përfundimtare të Projektit NETCET (Venecia, Korrik 2015), do të marrin pjesë në një Mbledhje pune të veçantë për të këmbyer përvojat e tyre dhe projektet e ardhshme.

Marco Affronte – për Rrjetin Teknik

Anna Zarotti – për Rrjetin Qytetar

Faqe në Facebook:

Faqja në Facebook është krijuar në Dhjetor 2012, dhe mund të gjendet në adresën:

<https://www.facebook.com/NETCETproject>.

Faqja mund të konsiderohet jo vetëm si një pikë informuese dhe propaganduese, por gjithashtu si një pikë kontakti dhe shkëmbim informacioni (rrjetëzimi) midis pjesëmarrësve në projekt dhe personave të interesuar. Faqja do të rifreskohet me lajme që kanë lidhje me Netcet dhe zhvillime të tjera që lidhen me tematikat e Adriatikut dhe Projektit Netcet (cetacetë, breshkat e detit, daljet e tyre në breg, etj...). Partnerët dhe të gjithë të interesuarit janë të inkurajuar të postojnë herë pas here lajme dhe përditësime.

Forumi

Forumi është organizuar si një mënyrë komunikimi virtual dhe diskutimi në internet, ku të interesuarit mund të bashkëbisedojnë në formën e mesazheve të postuara. Objektivi kryesor i forumit është të mbështesë, nxitë dhe përmirësojë diskutimin dhe debatin midis partnerëve, ekspertëve dhe publikut të gjerë, si dhe të këmbëjë njohuri dhe eksperiencë në mënyrë të plotë dhe të frutshme. Forumi është i ndarë në 5 kategori kryesore

- Deti Adriatik
- Cetacetë
- Breshkat e detit
- Projekti Netcet
- Pyetje për ekspertët.

"Pyetjet për ekspertët", është fusha ku vizitorët mund të postojnë pyetje rreth Detit Adriatik, breshkave detare, cetaceve dhe të marrin një përgjigje nga ekspertët e Netcet. Forum i Netcet është i hapur për këdo, por përdoruesit duhet të rregjistrohen (vetëm herën e parë), në mënyrë që të postojnë mesazhet.

Forumi mund të gjendet në adresën:

<http://netcet.freeforums.org/>

3. Si mund ta ndihmojmë një breshkë deti të plagosur, ose të dalë në breg?



This poster has been produced with the financial assistance of the IPA Adriatic Cross-Border Cooperation Programme. The contents of this publication are the sole responsibility of WWF Italy and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the IPA Adriatic Cross-Border Cooperation Programme Authority.

Projekti NETCET synon të zvogëlojë nivelin aktual të kërcënimeve ndaj breshkave të detit dhe popullatave të cetaceve në Detin Adriatik.

Në Mesdhe dhe në Adriatik kërcënimi kryesor paraqitet nga vdekshmëria e vazhdueshme gjatë kapjes aksidentale në mjetet e peshkimit. Mbi 130,000 breshka deti kapen rastësisht çdo vit në Mesdhe dhe prej këtyre kafshëve mbi 40.000 vdesin. Në Adriatik, mbi 11.000 breshka janë kapur rastësisht çdo vit, kryesisht nga rrjetat fundore (tratrat), mrexhat dhe grepat e peshkimit. Edhe pse disa kafshë janë transferuar me sukses tek qendrat e shpëtimit, natyrisht kjo nuk mund të bëhet për të gjithë ato mijëra breshka të kapura dhe në shumë raste kjo nuk është edhe e nevojshme për shkak se peshkatarët mund të shpëtojnë vetë lehtësisht breshkat. Kjo është arsyeja pse projekti NETCET, si shumë të tjerë në mbarë botën, është duke informuar sa më shumë peshkatarë të jetë e mundur, me praktikën më të mira që mund të zbatohen në anije për lirimin e breshkave të detit të kapura aksidentalisht dhe që nuk janë plagosur rëndë. Breshkat e kapura nga tratrat apo mrexhat mund të vdesin për shkak të pamundësisë për të dalë në sipërfaqe për frymëmarrje. Shumë prej tyre mund të gjenden të vdekura ose në gjendje kome. Breshkat në gjendje kome do të vdesin nëse lirohen menjëherë në atë gjendje, sepse ato nuk mund të notojnë në sipërfaqe për të marrë frymë. Ato mund të shërohen në qoftë se peshkatarë i mban

Paolo Casale, WWF Itali

mbi kuvertë për një kohë, me shpinën më lart se koka (kjo lehtëson largimin e ujit nga mushkëritë). Më pas, peshkatarë mund ta lëshojë breshkën në ujë kur ajo bëhet aktive. Breshkat e kapura me grepa janë gjetur përgjithësisht në kushte të mira, por shumë prej tyre do të vdesin së shpejti nga gëlltitja e fillit dhe grepit. Megjithatë, shumica e këtyre vdekjeve mund të shmangen nëse peshkatarë heq grepin, nëse ai është në gojë, ose të paktën pret fillin shumë të shkurtër para se të lirojë breshkën. Filli është provuar të jetë edhe më i rrezikshëm se grepi, sepse ai gëlltitet dhe më pas pret ose deformon zorrën, duke shkaktuar një vdekje të ngadaltë dhe me shumë vuajtje. Edhe një pjesë relativisht e shkurtër e fillit të peshkimit (p.sh. 50 cm) mund të jetë vdekjeprurës. Prandaj, edhe me trajtime të thjeshta peshkatarët mund të bëjnë një ndryshim të madh për mbijetesën e breshkave. Me qëllim që të informojë dhe të përfshijë peshkatarët e Adriatikut, projekti NETCET ka përgatitur një poster që përshkruan se çfarë duhet bërë në rast se një breshkë është kapur nga një rrjetë fundore, mrexhë apo grep. Ky poster do të shpërndahet në portet kryesore të Adriatikut. Përveç kësaj, informacion i njëjtë, i thjeshtuar përmes vizatimeve të përshtatshme, do të vendoset në afishe dhe bluza. Këto materiale të prodhuara nga projekti do të shpërndahen gjatë takimeve të veçanta me peshkatarët.

Shumë breshka janë gjetur gjithashtu edhe përgjatë bregdetit, të vdekura apo pothuajse të vdekura, si pasojë e dëmtimeve nga helikat e anijeve të peshkimit, përplasjes me varka (dhe ky është subjekt i një fushate tjetër sensibilizuese të projektit) dhe arsye të tjera. Nëse dërgohen menjëherë në një qendër shpëtimi këto kafshë ndoshta mund të shpëtohen. Prandaj, projekti NETCET është duke informuar publikun e gjerë se kush duhet kontaktuar në këto raste. Opsioni më i mirë është që të kontaktohet gjithmonë zyra më e afërt e Rojes Bregdetare, e cila është në kontakt me qendrat e shpëtimit të breshkave në zonë. Ndërkohë, breshka duhet të mbahet lagësht, veçanërisht koka dhe sytë, duke përdorur ujë të detit dhe në verë ajo duhet të vendoset në hije, përndryshe temperatura e saj do të rritet në nivele vdekjeprurëse.

4. Workshopi “Ngritja dhe funksionimi i qendrave të urgjencës/shpëtimit për breshkat e detit dhe cetacetë” Riccione (Itali) – Shkurt 2013



Më 21-23 shkurt 2013, në Riccione (RN), Itali, u mbajt workshopi i fokusuar në ngritjen dhe funksionimin e qendrave të emergjencës / shpëtimit për breshkat e detit dhe cetaceve. Workshopi u organizua nga Fondacioni Cetacea me mbështetjen e Universitetit të Padovas dhe WWF-Itali. Ai kishte për qëllim fuqizimin e kapacitetit institucional për trajtim të menjëhershëm dhe të duhur të breshkave të detit të plagosura dhe të dala në breg, si dhe të cetaceve, duke u fokusuar në protokollet e miratuara.

Leksionet e workshopit paraqitën teknikat e aplikuara për shërimin e këtyre llojeve dhe gjithashtu praktikatat veterinarë për ndihmën e parë apo diagnoztikimin. Gjithashtu, Fondacioni Cetacea është marrë si shembull për të shpjeguar se si duhet të organizohet dhe menaxhohet një qendër shpëtimi për breshkat e detit.


Përveç kësaj u përmend rëndësia e bashkëpunimit midis Qendrave të Shpëtimit dhe Rrjeteve Rajonale të cilat punojnë për mbrojtjen e breshkave të detit dhe cetaceve. Në fund të aktivitetit, një debat interesant nënvizoi se qendrat e shpëtimit mund të konsiderohen si instrumente të dobishme për fushata ndërgjegjësuë mbi praninë e cetaceve dhe breshkave të detit në Detin Adriatik. Qendrat e shpëtimit kanë një lidhje të ngushtë me shumë prej aktorëve të përfshirë direkt në jetën e këtyre llojeve të rrezikuara: publiku i gjerë, institutet e kërkimit, peshkatarët, etj

Tek faqja e internetit e projektit NETCET mund të gjeni raportin e këtij workshopi. Për detaje të mëtejshme mund të kontaktoni lektorët, nëpërmjet Fondacionit Cetacea; e-mail: educazione@fondazionecetacea.org

Valeria Angelini, Fondacioni Cetacea Onlus

5. Workshopi “Monitorimi i metodave të vëzhgimit për balenat dhe breshkat e detit në Adriatik”, Loshinj (Kroaci), Mars 2013

Në datat 20 - 22 mars 2013 Instituti “Blue World” organizoi workshopin mbi monitorimin e metodave të vëzhgimit të cetaceve dhe breshkave të detit në Adriatik. Seminari synonte siguruarimin e përputhjes midis partnerëve të Netcet në zhvillimin e sistemeve të monitorimit dhe protokolleve për ruajtjen dhe mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare në Adriatik. Këto janë lloje shtegtuese që lëvizin ndërmjet vendeve të Adriatikut, prandaj realizimi i një monitorimi të vazhdueshëm do të ndihmojë në ruajtjen e tyre duke përdorur një qasje më tërësore për mbrojtje. Në ditën e parë u prezantua një pasqyrë e rajonit të Detit Adriatik dhe potencialit për zhvillimin e projekteve të mëtejshme në lidhje me qëllimet e projektit NETCET. Qëllimet dhe objektivat e programeve të monitorimit u prezantuan duke përfshirë një rishikim të mundshëm të cetaceve dhe llojeve të breshkave të detit që mund të gjendet në Detin Adriatik.



Dita e dytë filloi me detaje mbi punën kërkimore për cetacetë, duke përfshirë metodat e hulumtimit dhe kërcënimeve ndaj këtyre kafshëve në Detin Adriatik. Seanca e pasdites u organizua si një takim pune për

metodat e analizës teknike duke përfshirë një rishikim të programit "light-room", i cili do të përdoret në analizën e të dhënave për projektin. Dita e tretë iu përkushtua logjistikës, protokolleve dhe metodave të vëzhgimeve ajrore për cetacetë dhe breshkat e detit në Adriatik, duke theksuar të gjitha çështjet e mundëshme rreth zhvillimit të kërkimit nëpërmjet kësaj teknike. Nga ky workshop është konstatuar se shumë nga skemat bashkëvepruese të monitorimit, mund të aktivizohen sipas disponueshmërisë së partnerëve të trajnuar gjatë muajve të ardhshëm.

Raporti i workshopit në Losinj gjendet në faqen e internetit të NETCET.

Nga teoria në praktikë, në qershor të vitit 2013 filloi vëzhgimi me varka në det për cetacetë brenda ujrave territoriale të Republikës së Malit të Zi, si bashkëpunim mes BËI (Blue Eorld Institute) dhe Institutit të Biologjisë Detare në Kotor. Vëzhgimet e mëtejshme për Shqipërinë do të ndërmerren në pranverën e vitit 2014. Vëzhgimi ajror është planifikuar të realizohet gjatë periudhës Korrik - Gusht 2013, në varësi të personelit në dispozicion dhe përfundimit të procedurave logjistike. Vëzhgimi do të koordinohet nga ISPRA - Instituti Kombëtar Italian për Mbrojtjen dhe Studimin e Natyrës dhe BËI si partner me organizata të tjera nga brigjet lindore të Adriatikut.

Për detaje të mëtejshme mbi monitorimin e progresit mund të kontaktoni në faqen e internetit të BËI, ose nëpërmjet info@blue-world.org.

Peter Mackelworth, *Blue World Institute*

6. . Kurset e trajnimit veterinar të NETCET në Itali dhe Kroaci (Maj -Qershor 2013)



CORSO DI FORMAZIONE PER VETERINARI IN GESTIONE E CONSERVAZIONE DI CETACEI E TARTARUGHE MARINE NELL'ALTO ADRIATICO

13-17 Maggio 2013
Agropolis - Aula 15 Pentagono
 Viale dell'Università 16
 LEGNARO (PD)

CETACEI
Lun.13 (9:00-17:00): Anatomia, Fisiologia, Biologia-Etologia, Malattie Infettive e Parassitologia
Mart.14 (9:00-17:00): Tossicologia, Patologia e Clinica
Merc.15 (9:00-17:00): Normativa comunitaria, Impatto antropico, Zoonosi e Biosicurezza, Gestione dei Volontari, Biologia dell'Adriatico e parte pratica in campo

TARTARUGHE MARINE
Merc.15 (9:00-17:00): Normativa comunitaria, Impatto antropico, Zoonosi e Biosicurezza, Gestione dei Volontari, Biologia dell'Adriatico e delle Tartarughe, Anatomia e Fisiologia
Giovedì.16 (9:00-17:00): Farmaco-tossicologia, Microbiologia, Parassitologia, Clinica Medica
Ven.17 (9:00-17:00): Clinica Chirurgica, Patologia e Necropsia pratica

La partecipazione è gratuita. Poiché sono disponibili 25 posti, sarà considerato l'ordine d'arrivo delle iscrizioni. Le richieste dovranno pervenire alla mail memmeferimarin.bca@unipd.it indicando il proprio nominativo, afferenza, titolo di studio, professione, contatti telefonici ed indirizzo e-mail. Sarete contattati con programma definitivo e indicazioni logistiche. Per info: cinzia.cantafelghes@studenti.unipd.it

Let's grow up together
Adriatic IPA
 Cross Border Cooperation 2007-2013
 0011 1 800 611 222 222 020 000 000 000

Questo volantino è stato prodotto con il contributo finanziario del Programma di cooperazione Transfrontaliera IPA Adriatico. I contenuti di questo volantino sono di esclusiva responsabilità dell'Università degli Studi di Padova e in nessun caso riflettono la posizione delle Autorità del Programma di cooperazione Transfrontaliera IPA Adriatico.

zgjatën një javë, ishin të përshtatura për nevojat territoriale të vendeve të ndryshme të Detit Adriatik. Qëllimi ishte për të përhapur njohuritë e fituara gjatë viteve nga Universiteti i Padovës (Departamenti i Biomjekësisë Krahësuese dhe Shkencave të Ushqimit) dhe Universiteti i Barit (Departamenti i Mjekësisë Veterinare). Një pjesë e të gjitha kurseve ishte kushtuar për të kryer disa procedura praktike, përfshirë gjithashtu disa studentë të mjekësisë veterinare.

Për pjesëmarrësit u dha informacion i përgjithshëm mbi ekologjinë e Adriatikut, si edhe një vështrim mbi kuadrin ligjor në lidhje me këto lloje. Pjesëmarrësit u përditësuan në biologjinë, anatominë dhe fiziologjinë e këtyre vertebrorëve detare. Gjatë kurseve, lektorët dhanë informacion në lidhje me patologjitë e breshkave detare dhe cetaceve, si dhe problemet e mëdha të shkaktuara nga veprimtaritë njerëzore ndaj këtyre llojeve (p.sh. peshkimi ose zhurmat). Në fund, u treguan procedurat kryesore të ndihmës së parë dhe lëshimit në det. Pas këtij trajnimi bazë, të dy departamentet do të japin një mbështetje të vazhdueshme nga distanca. Tani veterinerët janë të gatshëm të punojnë në terren.

Sandro Mazzariol, Universiteti i Padovës

Nga maji deri në qershor 2013, në kuadër të projektit NETCET, u organizuan tre kurse të trajnimit veterinar në Padova (Itali), Rijeka (Kroaci) dhe Bari (Itali). Gjatë këtij trajnimi rreth 120 pjesëmarrës, veterinerë dhe profesionistë në këtë fushë, u përditësuan mbi aspektet biologjike dhe teknikat specifike mjekësore në lidhje me cetacetë dhe breshkat detare. Trajnimet, që

Lajme shkurt

Takimi i ardhshëm i partnerëve të projektit në Koper – Shtator 2013



Takimi i ardhshëm i partnerëve të projektit do të mbahet në Koper (Slloveni) në shtator të vitit 2013, i ndjekur nga kursi për jo-profesionistët, mbi "trajtimin, shërimin dhe regjistrimin e breshkave të detit dhe cetaceve të kapura aksidentalisht, ose të dala në breg". Në dhjetor 2013 do të organizohen 3 kurse të tjera, në Padova (Itali), Rijeka (Kroaci) dhe Patok (Shqipëri).



The project is co-funded by the European Union,
Instrument for Pre-Accession Assistance.



Contact

City of Venice

info@netcet.eu

Economic Development, European
Policies and Strategic Plan Division

+39 041 2747826 / 7830 / 7834

San Marco 4299
30124 Venice - Italy

www.netcet.eu

www.facebook.com/NETCETproject

This Newsletter has been produced with the financial assistance of the IPA Adriatic Cross-Border Cooperation Programme. The contents of this Newsletter are the sole responsibility of the City of Venice and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the IPA Adriatic Cross-Border Cooperation Programme Authorities.